*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

E mërkurë, 31 maj 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur.

Z. Sekretar, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar i Gjykatës.

Së pari, ju lutem palëve të prezantohen, duke filluar me ZPS-në.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. ZPS-ja sot përfaqësohet nga Line Pedersen, menaxhere e rastit; Giulia Bianchi, konsulente; Gaia Pergolo dhe Eva Wyler, asistentprokurore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita. Më quajnë Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave, së bashku me znj. Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat i Mbrojtjes.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Sot z. Shala është i pranishëm përmes videolidhjes. Jam së bashku me z. Hedi Aouini, znj. Cariolou; menaxheren e lëndës, znj. Petravica; dy asistent Juliette Healy dhe Judit Kolbe; dhe dy stazhiere Xhulia Tepshi dhe Camille Gosson.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

Z. Shala, ju lutem a më konfirmoni nëse më dëgjoni mirë?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po. Mirëmëngjes. Ju ndëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Do të vazhdojmë sot me pyetjet që do t'ia bëjë Dëshmitarit 1 Prokurori i Specializuar. Sërish do të bëjmë tri seanca të rregullta nga një orë e gjysëm. Do të bëjmë pushimin prej 30 minutash dhe pushimin e drekës prej 90 minutash.

Përpara se të vijojmë, dëshiroj që t'i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave dhe Avokatit të Mbrojtjes për dy çështje. Për çështjen e parë dua që të kalojmë në seancë private.

Z. Sekretar, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Një sqarim për palën Mbrojtëse.

Ditën e premte morëm përgjigjen e Mbrojtjes ndaj kërkesës së ZPS-së për të futur në procedurë deklaratën paraprake të Dëshmitarin 2 sipas rregullës 153 të Rregullores.

Ne e mbajtëm shënim kërkesën tuaj, Trupi Gjykues e rrëzon kërkesën tuaj për ta rrëzuar kërkesën e ZPS-së dhe për t'i dhënë urdhër ZPS-së që të thërrasë Dëshmitarin 2 që të japë

dëshmi drejtpërdrejt në sallën e gjyqit.

Trupi Gjykues e konsideron të nevojshme që të bëjë disa sqarime sa i takon kësaj dhe kjo nuk e paragjykon vendimin tonë sa i takon kërkesës së ZPS-së. Trupi Gjykues synon që të marrë vendim për kërkesën e ZPS-së pas dëshmisë së Dëshmitarit 1 në varësi të disa situatave të ndryshme: Ne mund të vendosim që ta pranojë në prova gjyqësore deklaratën e mëparshme të Dëshmitarit 2 në vend të dëshmisë të dhënë gojarisht; Trupi Gjykues mund të vendosë që të pranojë deklaratat paraprake në vend të marrjes në pyetje nga pala thirrëse dhe ta thërrasë për kundrapyetje që t'i bëni ju; ne dhe mund ta rrëzojmë kërkesën e ZPS-së.

Por në atë rast, se hë për hë, dëshmitari nuk është më në listën e dëshmitarëve, është ZPS-ja pastaj që mund të vendosë ta thërrasë apo jo dëshmitarin përpara mbylljes së paraqitjes së provave, ose mund të vendosë ZPS-ja që mos ta thërrasë. Është në tagrin e ZPS-së. Trupi Gjykues mund të ushtrojë kompetencat e veta pastaj në bazë të rregullës 132 të Rregullores, për ta thirrur dëshmitarin nëse e konsideron të nevojshme për gjetjen e së vërtetës.

Ne synojmë që të japim vendim për këtë kërkesë të ZPS-së pasi të kemi përfunduar dhënia e dëshmisë nga ky dëshmitar që kemi tani. Atëherë do të shikojmë se cilën rrugë do të ndjekim. Dhe pastaj jemi në atë pikë të procesit ku nuk do të jetë më e mundshme, sipas mendimit tonë, nëse do të vendosim

që dëshmitari do vijë gjithsesi në sallë, ose mund të jetë edhe përmes videolidhjes, ose fizikisht këtu, kjo nuk do të jetë javën tjetër. Këtë desha t'jua bëj të qartë. Hë për hë këtu jemi.

Po, ju lutem.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Ne e dimë që është në listën e dëshmitarëve, nëse nuk e kam gabim?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është në listë, por jo për dëshmi në sallë. Sepse varet nga rezultati i kërkesës së paraqitur.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ne kemi ndërmend që të merremi me këtë dëshmitar në këtë bllok apo në bllokun e ardhshëm. Nuk ka rëndësi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju kuptoj por nuk është në listën e dëshmitarëve për të dhënë dëshmi drejtpërdrejt para Trupit Gjykues nga ato që ka vendosur tani ZPS-ja dhe sesi do të vijojmë me këtë, kjo është një çështje e hapur ende.

Desha vetëm që t'jua bëj me dije se ku ndodhemi tani sa i takon logjistikës dhe administrimit kohor, që edhe nëse Trupi Gjykues do të merrte vendim në një mënyrë që do të kishte pjesërisht të themi, në thonjëza, nga dëshmitari i drejtpërdrejtë, pra, Trupi Gjykues, kjo nuk do të ndodhë javën e ardhshme. Thjesht desha të sigurohesha që palët ta dinë sa i takon kohës. Hë për hë kjo është.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

Ju shikoj që po tundni kokën në shenjë pohuese, është e qartë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Kemi bërë vlerësimin që nëse miratohet apo rrëzohet kjo kërkesë, atëherë nga ana logjistike do të ishte thuajse e pamundur që të merreshim me këtë dëshmitar javën e ardhshme. Këtë e kemi të qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Thjesht për t'i sqaruar gjërat. Mirë pra.

Mendoj se tani jemi gati – ah, shoh që jeni ngritur z. Prokuror.

Jo. Më falni. Mund të vazhdoni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk desha që t'ju ndërpres.

Mendoj se është një moment i duhur për të bërë një korrigjim sa i takon një numri ERN të cilin e dhashë dje, të cilin me sa kuptova është i pasaktë.

Dje në faqen 1406 të transkriptit, po diskutonim dëshminë e një personi të caktuar në një gjykim tjetër dhe unë thashë se dëshmia, rreshti 21 bëhet fjalë, faqja 1406.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, mund ta ulni faqen, se është shumë e dukshme. Nuk e di nëse keni ndonjë gjë në fletë që nuk duhet të shikohet, po thjesht për t'ju thënë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Fillon pra, dëshmia SITF00016926, kështu e thashë po, në fakt, është

SITF00016296, pra, jo 926, po 296.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Tani është në procesverbal dhe do të ndihmojë me siguri referencat në të ardhshmen për këtë transkript dhe për këtë dokument.

Atëherë mund të vijojmë me pyetjet që do t'i bëjnë dëshmitarit.

Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroheni dëshmitarin të hyj në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Dëshmitar. Më dëgjoni?

DËSHMITARI: Po. Mirëmëngjesi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si jeni sot?

DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Do të vijojmë sot me pyetjet që do t'jua bëj Zyra e Prokurorit të Specializuar. Tani do t'ia jap fjalën z. Prokuror në mënyrë që ai të vijojë. Në rregull. Shoh që po pohoni me kokë. Shumë mirë. I keni mirë ndëgjueset?

DËSHMITARI: Mirë. Mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndërkohë që z. Prokuror bëhet gati, ju rikujtoj, z. Dëshmitar, se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën. E kuptoni

këtë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Prokuror, keni fjalën.

DËSHMITARI: TW4-01 [Vijon]

Pyetje nga Z. De Minicis: [Vazhdim]

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

PË. Mirëdita.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ma merr mendja jemi në seancë publike aktualisht?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duhet të tregojmë kujdes atëherë.

PY. Z. Dëshmitar, dje e përfunduam ditën pasi folëm për keqtrajtimin që ju bë juve dhe personave të tjerë që ndodheshin me ju atë ditë. Sot, dua që të vijojmë sipas rendit kohor. Por përpara kësaj janë nja dy a tre pyetje të cilat dua t'i sqaroj me dëshminë e djeshme, pastaj të vazhdojmë.

E para si sqarim që kërkoj ka të bëjë me diçka që është regjistruar në faqen 1413, rreshti 24 dhe në faqen 1414, rreshti 6 i transkriptit të djeshëm.

Po ju pyesja dje për dy-tre ditët e para pas arrestimit

tuaj në shtab. Dhe ju pyeta, nëse gjatë këtyre dy-tre ditëve a mund të lëviznit lirisht brenda shtabit, për shembull, nëse nga magazina mund të dilnit në oborr edhe të ecnit. Dhe thatë:

"Jo. Fillimisht, nuk më lejohej që të largohesha sepse po kryenin verifikime".

A e kam kuptuar qartë që edhe gjatë dy-tre ditëve të para jua kishin kufizuar lëvizjet?

PË. Po, e saktë është.

PY. Dhe dikush ju tha që nuk mund të dilnit nga magazina?

PË. Jo, nuk na ka thënë askush. Po pasi që na i lidhën duart, e kuptum se paskan pasë urdhër.

PY. Më falni, se nuk isha unë i qartë saç duhet. Përpara se t'jua lidhnin duart. Përpara se t'jua lidhnin duart, pra, thatë kur po luanit me letra me ushtarët, gjatë asaj kohe, pra, para se t'jua lidhnin duart, a mund të lëviznit lirisht në oborr apo ishit të kufizuar? Ishit vetëm brenda magazinës apo ishit të kufizuar në lëvizje?

PË. Jo, vetëm brenda në magazinë. Nuk kena dalë jashtë. Pasi që na kanë lidhë, e kam kuptu se e paskemi pasë të kufizume.

PY. Në rregull. Ky ishte sqarimi i parë që doja. I dyti ka të bëjë me --

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duhet të kalojmë në seancë private për këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të doja të tregoja një fotografi tjetër që ju tregua dhe dëshmitarit gjatë intervistën që pati me Prokurorinë më *[REDAKTUAR]* Prandaj do ju kërkoja të shfaqni në ekran --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe kjo për qëllime identifikimi është?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Atëherë nëse mund të vendosim në ekran materialin me numër 059118 deri në 059154 RED2, faqja 7. Mund ta zmadhoni pak ju lutem. Edhe të shkojmë

pak më lart.

PY. Z. Dëshmitar, ua treguan këtë fotografi gjatë intervistës me Prokurorinë më *[REDAKTUAR]*. A të kujtohet që ua treguam atë ditë këtë fotografi?

PË. Ka harru, po e njoh unë. Këtu Pjetri është vetë.

PY. E sheh nënshkrimin tuaj në fotografi?

PË. Po, po. Po, shumë mirë.

PY. Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mund ta heqim fotografinë nga ekrani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Sekretari e hoqi nga ekrani fotografinë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Edhe në këtë rast përsëri, për qëllime identifikimi. A mund të vendosim në ekran materialin me numër SITF0012895 deri në 0012913 RED, në faqen 15, ju lutem.

PY. Z. Dëshmitar, a e shihni nënshkrimin tuaj tek dokumenti?

PË. Po.

PY. E njihni personin që është tek numri 42?

PË. Po, Sabit Geci.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mund ta heqim dhe këtë dokument tani nga ekrani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar, hiqeni nga ekrani fotografinë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Në fakt më

duhet po i njëjti dokument, po në faqen 16.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund të shkoni pak poshtë ju lutem.

PY. Dëshmitar, e shihni nënshkrimin tuaj poshtë fotografisë numër 53?

PË. Xhemshit Krasniqi.

PY. Xhemshit Krasniqi është personi tek numri 53 ku ke vendosë dhe nënshkrimin?

PË. Po. Po. Numri 53 poshtë, në fillim Xhemshit Krasniqi është.

[Seancë private]
[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

A ju kujtohet një incident që ka ndodhur në dhomën ku të mbanin të ndaluar dhe në këtë rast Sabit Geci, ushtarë, ushtarë të policisë ushtarake rrahën disa ushtarë që ishin po ashtu të ndaluar në të njëjtën dhomë që ndodheshit dhe ju?

PË. Po, kjo më kujtohet.

PY. A ju kujtohet kush ka qenë në këtë grup, pra, grupi që kreu rrahjet?

PË. Për Sabitin më kujtohet. Po për këta tjerët e di se janë kanë disa vetë janë kanë, po taman jo. Veç e di se i kanë rrahë do ushtarë të UÇK-së se kanë ardhë pi frontit e kanë pru një të plagosun në spital. Ke q'aty a kanë shkaku. Ja kanë pasë thej, këputë edhe palicën për kokë njënit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PË. Herën e dytë na kanë, më kanë rreh prapë sa kanë mujt. Po emnat saktë nuk janë tu mu kujtu. E di se janë kanë grup e kësi të mëdhej janë kanë, po me emna i kam harru për besë. E kam pasë shumë maltratime shpesh. Nuk po i di atëherë kur, qysh.

PY. A ju kujtohet a përdorën ndonjë send në atë rast kur ju rrahën ndonjë objekt?

PË. Po më kujtohen se më kanë rreh me çdo gjë, me shufra, me gjithçka, me palica. Gati sukur të njëjtën mënyrë të parën herë si ma kanë bë, ma kanë bë edhe të dytën.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jeni në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Më vjen keq për këtë. Do jem përpjekur që ta zgjidhim.

Z. Dëshmitar, tani jemi në seancë publike, ju lutem tregoni kujdes.

DËSHMITARI: Po e shoh edhe këtu se po shkrun.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, tani që folëm për incidentet që ndodhën në zyrë, dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje për gjëra te cilat kanë ndodhur në dhomën e ndalimit. Po akoma nuk do të flasim për ngjarjet që në veçanti ju kanë ndodhur juve *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Këto do t'i trajtojmë në seancë private. Por, hë për hë, dëshiroj që t'ju pyes nëse ka ndodhur ndonjë maltrajtim që ju e keni parë vetë me sytë tuaj në dhomën e ndalimit, pra, në dhomën numër 1?

PË. Në dhomën e ndalimit çdo gja se a ba kam qenë aty. Asnjëherë nuk ka pështu gjë pa i pa unë aty shka ka ndodhë.

PY. A keni parë ndonjë rrahje në dhomën e ndalimit?

PË. Po, kam pa. Shumë, jo pak.

PY. Kush po e pësonte të rrahurën në këtë rast? Cilët ishin viktimat?

PË. Kanë qenë njëherë i kanë pasë pru tre ushtarë. Se e kanë pru një të plagosun në spital. Dhe shkaku gjoja pse e kanë lëshu frontin, i kanë shti në dhomë tonë. I kanë rreh. I kanë

mbajt një dita, të nesërmen i kanë lëshu, më duket, se në mbrëmje i kanë lëshu, po në mëngjes i kanë pru. I kanë rreh para, në prezencë tonën. Deri sa i kanë këputë palicën, shufrën këto të gomës, të policisë se kanë qenë më përpara deri sa ja kanë këput në kry. Atë mbrëmje a nesërmit, më duket, i kanë lëshu, i kanë çu në front prapë.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

PY. Përmendët edhe persona tjerë të cilët i mbanin të ndaluar me ju dje, përfshirë, për shembull edhe tre romë. Po këtyre a keni parë t'ju bëjnë gjë në dhomën e ndalimit?

PË. Po i kanë rreh ata. E mue. Persona tjerë si janë kanë kur kanë hi në dhomë përgjithësi na kanë rreh të tanëve. Nuk ka pshtu kush pa u rreh.

PY. Të ndaluarve a ju dha urdhër që të bënin diçka njëri-tjetrit?

PË. Po i kanë detyru me i sjellë njëni-tjetrit në shuplaka.

PY. A ju kujtohet identiteti i atyre që e kanë kryer këtë maltrajtim apo maltrajtimin në dhomë?

PË. Me emna i kam harru, se kemi pasë shumë raste. S'kam qejf me i cek emrat me i përzi dosjen pa nevojë. Se pesëqind herë kena pasë rrahje. Herë kanë ardhë do, herë do të tjerë. E me emna po i harroj ka pak. Atë ditë ku na kanë rreh me shuplaka se i kanë detyru me i sjellë njëni-tjetrin, atë ditë ka qenë

Sabiti aty. Po për këta tjerët kam harru dhe kush ka qenë.

Sabiti nuk i ka ra kuj, po kanë sjellë këta tjerët. Se s'ka pasë karrige ku me u ul e me na sjellë, se a kanë me dy këto, se a kanë si invalid, se të kish pasë ndoj karrigë ndoshta kish sjellë ndoj trup.

PY. Thatë se Geci ishte invalid aso kohe?

PË. Po.

PY. Nga e kuptuat ju këtë? Si e mësuat ju këtë? Një përshkrim mbase ju ka sjellë në këtë përfundim.

PË. Unë Sabit Gecin e njoh pi 1991. Edhe e di se a kanë plagos pi forcave serbe pi helikopterit dhe e kam pa me këto si janë, si ecin, me këta shkopinjtë se i kanë, si po thirren këto.

PY. E patë që ai mbante paterica, pra, ato shkopinjtë aty në Kukës?

PË. Po, po.

PY. A dini gjë nëse Sabit Geci kishte edhe ndonjë nofkë me të cilën e thirrshin?

PË. Po ata gjithmonë e kanë thirr Qopa. Edhe unë q'ashtu e kam thirr gjithmonë prej sa e njoh.

PY. A mund të na e shpjegoni këtë "Qopa"? Çdo të thotë kjo?

PË. Kjo është sikur ke qenë me metme pak, se ecje pak si shtrembë qenë. Se këtë e ka pasë edhe 1991 kur ka qenë në burg, se e ka pasë pi ndeshjes.

PY. Ju në ndonjë moment --

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Një moment ju lutem, të nderuar Gjykatës.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Meqë na kanë mbetur edhe 15 minuta nuk dëshiroj të kaloj në një temë për të cilën pastaj i bie që ta ndërpresë, mirëpo është temë e rëndësishme sipas mendimit tim. Dëshiroj që t'ju bëj një pyetje lidhur me gjëra të cilat i keni parë kur ju kanë mbajtur të ndaluar.

Na treguat dje - dhe do t'ju a jap më vonë referencën – por kishte një dritare nga dhoma e ndalimit prej së cilës shihej, siç e thatë ju, i gjithë shtabi. Ju kujtohet që e thatë kështu?

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të na jepni këtë numër reference, po edhe atë tjetrin që nuk na e keni dhënë ende?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. I kemi shënim, po i ndjekim.

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë private.

z. Sekretar, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë ndërprerjen për pushimin. Pushimi do të jetë deri në orën 10.30 minuta -- 11.30 minuta, ju falënderoj. Pra, pushimi do jetë deri në orën 11.30 minuta, dhe do të riktheheni sërish këtu atëherë. Faleminderit. Shoqëruesja e Sallës do t'ju shoqërojë të dilni nga sallë.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull atëherë. Tani bëjmë pushimin.

Bëjmë ndërprerjen e seancës këtu.

--- Pauza fillon në orën 10.55

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet. Me sa shoh nuk ka ndryshime nga ana e ZPS-së dhe Mbrojtja e Viktimave dhe asnjë ndryshim nga ekipi Mbrojtës. Shumë mirë atëherë.

Mund të vijojmë me pyetjet e Dëshmitarit 1.

Z. Prokurori fjala është për ju.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] A doni t'ju jap tani referencat që duhej t'i jepja më herët Trupit Gjykues.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, ju lutem më mirë ta bëjmë para se të vijë dëshmitari.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Referenca e parë që lidhet me atë rastin kur kanë çuar dy herë dëshmitarin tek zyra mund të gjendet në faqen 1468, rreshti 19.

Referenca e dytë që mungonte, që lidhet me dhomën në --

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

më falni me dritaren në dhomën e ndalimit që shihte nga shtabi, mund të gjendet në faqen 1424, rreshtat 4-7.

Dhe besoj se referenca e tretë është për dje, dhe ka të bëjë me batanijet, jo dyshekët. Dhe mund të gjendet në faqen 1430, rreshti 17 dhe pastaj faqja 1431, rreshti 7.

Besoj se këto janë referencat që duhet t'ju jepja.

Gjithashtu do të doja të informoja Trupin Gjykues dhe ekipin e Mbrojtjes se jemi duke nxjerrë shënimin zyrtar të takimit të kortezisë që kemi pasur me dëshmitarin, siç u pajtuam dje. Shpresojmë ta dorëzojmë këtë para përfundimit të ditës së sotme.

Gjithashtu do t'ju jap edhe një rishikim të kohës që më nevojitet për të bërë pyetjet. Besoj ka mundësi që të mbarojmë sot ose mund të bëjmë edhe nesër paradite. Kjo është parashikimi që mund të bëj për momentin, por e sigurt është që nuk do ta kalojmë seancën e parë nesër. Nuk do të shkojmë përtej kësaj seance.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për informacion z. Prokuror.

I drejtohem Mbrojtjes dhe mund t'ju komunikoj se do t'ju japim një ditë pas, pra do të kemi një ditë në mes pas përfundimit të pyetjeve nga Mbrojtësja e Viktimave edhe fillimit të pyetjeve tuaja. Do t'ju japim një kohë që ju të përgatiteni, nëse mendoni se është e nevojshme. Nëse mendoni se nuk është e nevojshme ne mund të ju mund të filloni

menjëherë me kundrapyetjet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Doni të thoni në qoftë se mbaron nesër Mbrojtësja e Viktimave ne do të fillojmë të hënën?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, të premten. Sot është e mërkurë.

Më falni, më falni. Po, po, të drejtë keni. Atëherë fillojmë të hënën. Keni shumë të drejtë. Po, të hënën atëherë. Por, nëse mbarojmë sot me të gjitha, atëherë do të filloni të premte. Atëherë mund t'ju informoj që tani se është e rëndësishme të kuptoni që Trupi Gjykues, pasi të mbarojë Prokuroria pyetjet e veta, dhe ne do të kemi disa pyetje. Nuk do ta bëjmë në fund. Mund të kemi edhe në fund fare, pasi të ketë mbaruar palët me pyetjet, por disa nga pyetjet do t'i bëjmë menjëherë pasi të bëjë pyetjet Prokuroria në mënyrë që pjesëmarrësit dhe ekipi Mbrojtës t'i kanë parasysh pyetjet tona dhe të mos të na dëgjojnë ne në fund fare dhe të mos kenë mundësi të reagojnë.

Në rregull. Besoj se mund të vazhdojmë.

Asistenti, ju lutem sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminders.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

vazhdojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

Fjala është për Prokurorin dhe jemi në seancë publike

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Mirë se u kthyet z. Dëshmitar

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më duhet të kalojmë në seancë private për pyetjet e radhës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe sapo të kalojmë për seancë private do na bëni me dije për çfarë bëhet fjalë

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë le të kalojmë në seancë private ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Në rregull. Tani shkojmë te dita tjetër *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* A mund të na tregoi çfarë ndodhi pastaj?

PË. Nuk e mbaj mend po kena pasë maltrajtime ne gati çdo ditë aty. Sa herë kanë ardhë këta të mëdhenjtë Xhemshita, e Sabita, e këta, sa herë kanë ardhë, pa na hy në dhomë me na rreh, nuk e kanë lënë. Me ushtarë kanë ardhë, me gjind. Kanë hup kohën q'aty me ne. Se në shtab a konë fronti, nuk a konë në Kosovë.

PY. Çfarë do të thuash me këtë kur thua që "në shtab ka qenë fronti dhe jo në Kosovë" që ta kuptojmë?

PË. Me ne kanë pasë punë. Nuk kanë pasë armiq për me dashtë me luftu në Kosovë. Unë s'jam kanë armik i tynve për me më maltrajtu përditë aty e përnatë sa herë kanë dashtë. Atje kanë dashtë me shku me luftu. [e pakuptueshme] armatosur, po as spiuna jo.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Kjo është një pyetje që mbase s’ta kam bërë deri tani. Po gjatë kohës që ke qenë i ndaluar atje, ti e kuptove në ndonjë moment kush ishte përgjegjës për burgun, për të burgosurit gjatë kohës që ti ke qenë i ndaluar deri në momentin

*[REDAKTUAR]*

PY. Për dhomat e burgut, për të burgosurit ka qenë Xhemshit Krasniqi. Por kur a konë Sabit Geci e sene s'ka guxu kërkush me i lujt. Se ai s'ka pyt kërrkënd.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private]
[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

Midis këtyre dy momenteve a e patë të akuzuarin Pjetër Shalën në raste të tjera?

PË. Sa e mbaj mend, jo më duket më. Nuk jam i sigurtë. Më duket se jo. Nuk e di. Se kam pasur shumë aksidente aty dhe s'un t'i mbaj mend shumë. Problem është me i mbajt mend krejt gjanat.

PY. *[REDAKTUAR]*, a ndryshoi diçka në shtab, në dhomën e ndalimit në kushtet në të cilat ndodheshit?

PË. Kanë pru një oficer burgi të Prizrenit për me na rujt neve. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*. E kam njoft atë. Është sjellë shumë mirë me ne. A sjellë thu ti se jena në burg normal të shtetit, qysh janë trajtu të burgosurit me ligje me rregulla. Na ka mundësu na ka bë mundësi, a konë një shator q'asaj dhomës numër 1, na ka çu me u la, po jena la veç me ujë të ftohtë se s'ka pasë ujë tjetër. Me shishe sende për me heq

atë gjak e sende qysh jena kanë, se një muaj e kusur pa u la hiç. As shampon as sapun, veç ujë kështu, me e heq gjakun.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Nuk isha shumë preciz shumë i saktë. Në përgjithësi fjalim gjatë periudhës që ishit ndaluar, se ju thatë për shembull që ju merrnin gjatë natës dhe ju kthenin në mëngjes. Po dikënd tjetër a e merrnin gjatë natës dhe e kthenin në mëngjes? Pra, a u ndodhi u ndodhi e njëjta gjë këtyre të

tjerëve, dikujt tjetër?

PË. Këtë të Drenicën e kanë marrë edhe e kanë marrë këtë të Suharekës. Të Suharekës një herë e kanë pasë rreh një herë aq keq e kanë rreh në zyrë atëherë e kanë pru q'aty në korridor tek dhoma numër 2. E kanë rreh edhe një herë aty. Ai kur ka ardhë në dhomë vonë dikur, kur ja kam hek bluzën për me ja hek ju ka hek me gjithë lëkurë gati. Ka qenë q'aty tek 60 vjeç, 58 vjeç, 60 vjeçar ka qenë me musteqe një. I gjatë ka qenë, i madh.

PY. A ju kujtohet kush ishin ata që ja bënë këtë gjë atij? A i njihnit?

PË. Nuk e kam pyet për besë. A këtu te dera kur e kanë çelë derën e kanë shti mrena e kam pa Xhemshitin. Po nuk kena pyt fort "kush të rrehi" se për ne s'a konë fort interesant kush na ka rreh. Interesant a konë dhimbtë e trupit e ç'ka a tuj na gjetë se çdo minutë e kena pa -- e kena prit kur të na vrajnë a të na mysin. Se për çdo natë edhe ç'ka vijshin luftëtarë prej frontit deshin me na hi në dhomë e nuk i lejka roja.

E na kena pa tmerr, na. Veç minutat i pritshnim kur të vdesim. S'kemi ditë ç'ka me fjetë, na u mshelshin sytë po gjumi nuk na zejke. Nuk e di a kemi ba ka pesë minuta, flej njoni, pesë minuta. Kur kalojke dikush a dilshin te dritarja të bërtitshin, na shajshin, na ofendojshin. "Q'itash të vijna", jo kajllxoshin ndonjë thikë prej dritares. "Kena me ardhë, kena me ja ba". Rrijte atëherë. Veç tuj prit kur po

kris dera. Kur a çelë derë e kemi ditë se dajaki krisi.

PY. Pas mbërritjes së Osman Hoxhës a vazhduan të rrahmet?

PË. Më duket se mo s’na ka prekë kurrkush. Sa maj mend s’na kanë rreh ma. Unë sa e maj mend.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, do bëjmë tani pushimin do të takohemi në orën 14.30 dhe Prokuroria do të vazhdojë me pyetjet e fundit. Unë ju uroj një drekë të mirë edhe të pushoni pak edhe shihemi bashkë në 14.30.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit asistentes që shoqëron dëshmitarin.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, do të kaloj nga kjo anë.

Me sa kuptova doni të thoni diçka.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mesa shoh që Prokuroria nuk ka asgjë për të shtuar lidhur me këtë.

Mbrojtësi i Viktimave doni të parashtroni diçka para se të bëjmë pushimin e drekës?

Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë prej nesh.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësja e Viktimave gjithashtu, pasi të përfundojë Prokuroria me pyetjet e veta mund të na thoni sa kohë do ju nevojitet. Mbase jo tani sepse këtë vlerësim mund ta bëni pasi të mbarojnë ata me pyetjet, por që të kuptojmë ´dhe ne si do të vijojmë pas kësaj.

Z. LAWS: [Përkthim] Patjetër, kështu do të veproj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Ndërpresim seancën dhe takohemi në orën 14.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.54

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se jeni rikthyer.

Vijojmë atëherë me marrjen në pyetje të Dëshmitarit numër 1.

Por më parë të verifikoj nëse është e njëjta përmbajtje e ekipeve. Po, ZPS-ja. po kështu Mbrojtësi i Viktimave. Po kështu edhe dy radhë këtu të mbushura me njerëz. Mbrojtja njëjta përbërje?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ma kapi syri.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Zonja Judit Kolbe nuk është këtu me ne, është z. Lanlais, që është i pranishëm, që është stazhier. Është edhe sigurisht, z. Shala me ne.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë z. avokat.

Në rregull, nëse nuk ka gjë të cilën do të donin ta ngrinin palët dhe Mbrojtësi i Viktimave, mund të vijojmë me shoqërimin e dëshmitarit që të hyjë në sallën e gjyqit.

Znj. asistente, ju lutem veproni kështu.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u rikthyet, z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të vijojmë me pyetjet të cilat do t'ua bëj z. Prokuror.

Jemi hë për hë në seancë publike.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Mirë se u rikthyet, z. Dëshmitar, nuk ka edhe shumë pyetje. Besoj se shpejt do të mbarojmë. Të paktën nga ana ime.

Kam nja dy pyetje sqaruese të cilat më lindën ndërkohë që po lexoja procesverbalin, tekstin, lidhur me atë ç'ka na thatë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do përpiqem që të bëj në fillim ato pyetjet që mund të bëhen në seancë publike dhe pastaj, nëse është nevoja, të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani jemi në seancë publike.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do bëni një herë pyetjet që mund të bëhen në seancë publike, pastaj do kalojmë në seancë private. Në rregull, shumë mirë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Na treguat për ushqimin që ua dhanë gjatë ndalimit. Cekët se s'ju interesonte fort ushqimi. Po a ratë në peshë, a humbët kile si pasojë e ndalimit atë muaj?

PË. Unë kur kam ardhur në shtëpinë time, nuk i kam pasur as 45 kile, 50 s'i kam pas.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse mund të kalojmë në seancë private, ju lutem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, do të na e tregoni atë për të cilën për të cilën do të diskutoni pasi të kaloni në seancë private.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. sekretare, kalojmë në seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Gjatë mbajtjes tuaj në ndalim në dhomën 1, a mos mësuat gjë vallë arsyen e ndalimit e një prej të ndaluarve të tjerë? Arsyen se pse i kishin ndaluar edhe ata të tjerët?

PË. Për këta të Drenicës e di se kish pasur punuar me transport, diçka, e gjoja se për ç'ka ka marr mall prej Serbie, se e ka prurë në Kosovë. E kësi gjëra. E transport, transport, a biznes. Dhe kur ka ardhur prej Gjermanie në Durrës, për të marrë vesh për fëmijët, familjen e vet, me e marr familjen e vet, atëherë e kanë arrestuar aty. Sipas këtij që më ka thanë, këtij të Drenicës i ka pasur nja 20 mijë marka me vete, i kanë marrë pasaportën, paret, edhe e kanë burgosur. Edhe maltrajtuar. Maltrajtimin e kam parë me sytë e mi, paret e pasaportën nuk e kam parë. Po këto janë fjalët e atij.

PY. Po për ndonjë prej personave të tjerë, ju kujtohet gjë. Nëse ju kujtohet. Domethënë, lidhur me arsyen pse i kishin ndaluar ata?

PË. Për këta të Suarekës, gjoja se kanë ndenjur me serbë. A ky i Suarekës, djalin e kishte pasur të veshur në UÇK. Djalin në luftë, a babën ja kanë mshel bashkë me mua aty. Babën, numër 1, të mbyllur me të rrahur.

PY. Nga e morët vesh këtë informacion lidhur me këtë njeriun nga Suareka?

PË. Po, vetë ku e kanë marrë në pyetje q'aty në dhomë ja bënin: "Qysh, djalin në luftë e ke, me ne është duke luftuar, e ti duke ndenjur me serbë". Tash a ka ndenjur a s'ka ndenjur, ai nuk e pranonte atë punë. Po këta e akuzonin.

PY. Ju kujtohet emri i këtij njeriut?

PË. Jo, për besë e kam parë në një shkrim, se janë edhe të dhëna. Se përpara e kam ditur, por e kam harruar, e tash ja kam harruar emrin. Ka qenë i gjatë, me mustaqe, i madh. Më i madh se unë, bile edhe nja 10 centimetra, besoj se po.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, kështu janë mbyllur pyetjet nga Zyra e

Prokurorit të Specializuar.

Përpara se të pyes Mbrojtësin e Viktimave nëse ka ndonjë pyetje për ju, kam unë disa pyetje.

Për këto pyetje na duhet që të kalojmë në seancë private, kështu që sërish do t'i kërkoj znj. sekretare të gjykatës të na kalojë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit për përgjigjen. Lidhur me këtë – jo, ju kërkoj ndjesë. Do flas për person tjetër tani. A kishte gra të tjera të ndaluara në kampin në Kukës? Me aq sa dini ju? Ose me aq sa ju kujtohet?

PË. Di se kanë qenë dy motra nga Gjakova.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ke më shumë informacion lidhur me këto dy motrat, emrat mbase?

PË. Emrat nuk ua di. I kam pas rrahur, i kam dëgjuar duke qarë pak. Kanë qenë në dhomën në 3-sh, i kanë pas prurë në 2-sh duke i marrë në pyetje, diçka, por nuk i dëgjoja mirë. I kanë rrahur pak. I kam parë edhe të nesërmen, veç kur kanë kaluar, kryet ja kam parë nga dritarja. Më s'i kam parë. As ku kanë shkuar, a janë gjallë, a ç'ka është puna e tyre, hiç nuk jam në ngjarje.

[Seancë private]
[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Këto ishin pyetjet e Trupit Gjykues për momentin. Tani i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave, edhe dëshiroj ta pyes nëse ai ka pyetje për dëshmitarin.

Z. LAWS: [Përkthim] Kam dhe besoj se më nevojitet rreth gjysmë ose – 45 minuta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave, faleminderit.

Tani, Z. dëshmitar, ne do të vijojmë me pyetjet dhe tani e ka radhën Mbrojtësi i Viktimave dhe besojmë e do të përfundojmë rreth orës 16.00 sot dhe pastaj do të mblidhemi sërish nesër. Do të takohemi sërish nesër, më saktë. Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave, fjala është për ju.

Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara gjykatëse.

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

PY. Z. Dëshmitar, mirëdita.
PË. [e padëgjueshme]
PY. Sikurse e dini, unë jam Mbrojtësi i Viktimave në këtë çështje gjyqësore, dhe do t'ju bëj disa pyetje lidhur me disa

tema. Në rregull?

PË. Në rregull.

PY. Kur të ndryshoj temë, unë do t'ju shpjegoj se cila do të jetë tema e radhës për të cilën do ju bëj pyetje. Në rregull?

PË. Në rregull.

PY. Pyetjet e para lidhen me mënyrat se si keni pësuar dëm, edhe shpresoj që të mos ju shqetësoj kur t'ju bëj këto pyetje dhe shpresoj që tua bëj këto pyetje në një mënyrë që s'ju shkakton dhimbje të panevojshme. A e kuptoni çfarë po them?

PË. Po, po. Në fakt, po kuptoj plotësisht.

PY. Atëherë tema e parë do të jetë *[REDAKTUAR]*. Ju thatë –

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave, mos duhet të kalojmë në seancë private?

Z. LAWS: [Përkthim] Po në fakt, duhet të jemi në seancë private dhe do të redaktojmë pyetjen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos kini merak, nuk kemi persona të pranishëm në galerinë publike.

Sekretarja e Gjykatës, ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*[Seancë e hapur]Riklasifikuar në bazë të F631* Por në fakt unë dua t'ju pyes si në vijim. A keni ende dhimbje për shkak të rrahjeve, dhe të faktit që *[REDAKTUAR]* Na the që ju dhëmbin ende

brinjët, nuk është nevoja ta përsërisni këtë, por përveç brinjëve, keni më dhimbje për shkak të rrahjeve *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

PË. Kam dhimbje të kokës. Kam të këmbës. Kur të ndryshon koha kam tepër dhimbje. Më kap nganjëherë stresi, më kap baza nervore. Kur të fle më duhet me u çue, bile një herë natën me e i ndërru teshat se bëhem ujë, krejt. Shpesh, jo çdo natë, por shpesh më ndodh. Ujë bëhem krejt. Duhet të ndërroj edhe teshat e krevatit, e të trupit. Q'aq të djersitme. Që tash me shku në hotel, me e pa teshat ish hala, edhe jastëkun.

PY. Faleminderit. Në fakt ju përgjigje pak edhe pyetjes tjetër që do të bëja, që janë vuajtjet mendore që ke përjetuar qysh prej vitit 1999. Thatë sot, në faqen 46 [sipas përkthimit]:

"Dhe kam vdekë njëherë, dy herë nuk vdes".

A mund të na shpjegoni diçka më shumë lidhur me këtë koment, apo me këtë që thatë?

PË. Mua më ka shpëtuar Zoti, këta s'më kanë shpëtuar. Unë kam qenë i vrarë, por mua Zoti më ka shpëtuar, *[REDAKTUAR]* Unë sot s'isha kanë. Për mua, unë jam i vdekur. Për këta jam i vdekur unë jam i dekun, mu më kanë vra. Sa më ka shpëtu Zoti, mua më kanë vrarë. Ndryshe nuk vritet njeriu, as nuk mundesh. Plumbi të kap në krye, vdes menjëherë. Mua këta ma kanë nxjerrë shpirtin ngadalë-ngadalë. Qysh kanë dashur vetë. Njëri ndryshe nuk vdes. Tash *[REDAKTUAR]*, e di ç'ka është dajaku,

di se dhimbje më të madhe s'ka. Edhe nesër me më marr dikush, me më maltrajtu, i di ç'ka janë dhimbjet. Më tepër se më kanë bërë këta, s'mund të bëjë kush [e pakuptueshme]. Veç më pak, më tepër jo. Kam përjetuar krejt.

Se thotë dikush, me përjetu filma, se i kanë parë sendet. Filmat janë vetëm me i thanë me i këqyr. Ma zi se filmi janë, ç'ka kam parë në jetë temen, e ç'ka kam përjetu, mos pastë kush. Veç pesë minuta me pas dikën në lëkurën time, mundohet me ik prej lëkurës time.

Unë s'e kisha menduar këtë punë kurrë. S'kisha mujt me e ba. Me vra, po. Me maltrajtu q'ashtu, me ba kësi pa fije mëshire, duke qeshur e duke luajtur hajgare. Krejt muj me i thonë, por "njeri" s'mund t'i them atij njeri. Ja kam lënë zotit.

PY. Ajo që të ndodhi, si ndikon në jetën tuaj të përditshme aktualisht?

PË. Në jetën time ndikon për së tepërmi, shumë. Pa masë. Për mua s'është jeta interesante më. Kanë mundur me luajtur në fytyrën time, me ndërgjegjen time, me ndërgjegjen e familjes time. *[Seancë private]*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. A je në gjendje t'i lësh pas kujtimet e asaj që të ka ndodhur në Kukës apo jo?

PË. Jo, s'muj kurrë përjetë me i lanë. Edhe me dashtë. Janë programuar këtu. Edhe këtu. S'mundem. Me e pas mujt, s'më kishe parë as këtu.

PË. Ju na treguat se si ndjeheni apo çfarë përjetoni kur flini. Pse djersitni, çfarë është ajo që shkakton këtë mungesë rehati, këtë shqetësim dhe ju djersini kaq shumë?

PË. S'e kam pasur kurrë këtë punë. Kurrë s'e kam pasur. Mbas lufte e kam. Nuk e di. Nganjëherë tremben në gjumë, kërcej trupi, apo. Më del gjumi. Unë nuk është se shoh ndonjë ëndërr. Trupin më kërcen, nuk e di as vetë, s'muj me e kuptu as vetë.

PY. Po gjatë ditës?

PË. Ditës kur të jem me shoqëri, sende, jam në rregull -- sende. Jam pak agresiv me muzë diku, se jam shumë më agresiv

se përpara se kam qenë. Nuk duroj fort. Por me shoqëri kur jam, jam në rregull. Kur jam vetë, rri në mendime. Ndonjëherë q'ashtu, q'ashtu tash me nja dhjetë minuta, sa jam duke ndenjur kështu pa folur, krejt këto kockat sa jam q'kështu, kështu i ndjej. Se s'di ç'ka me bo, kapi tuj ndie ndonjë send. Baj matematikë, sa xhama janë, sa kocka janë, sa kompjuterë janë -- me u kanë. Bie në mendime, bie diku.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Pse nuk ndiheni i sigurt? Çfarë ndjeni?

PË. Po qysh me kanë i sigurt, se e kanë edhe frikën e vet tash se ç'ka kanë bërë. Thotë "këtë ta vras, sa s'më ka vrarë" se e di ç'ka ka bërë. E dinë ç'ka më kanë bërë. Pa arsye. Besomë, në Zot, se të isha kanë unë spiun kurrë as s'isha marrë me atë punë. Kurrë s'isha marrë. Kisha thanë "mirë ma kanë bërë". Veç spiuni me këqyr me kanë, me e bo dikë spiun,

mua q'kjo më mundon. Q'kjo më mundon shpirtërisht mua.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Kemi përfunduar kështu, z. Dëshmitar, pyetjet nga Mbrojtësi i Viktimave. Ju falënderoj shumë për kohën sot. Ju rikujtoj edhe njëherë se deri nesër nuk duhet të flisni për dëshminë tuaj këtu me askënd. Do t'ju shoqërojë dikush nga Zyra Administrative e Gjykatës. Përpiquni të pushoni sado pak. Do të shihemi sërish pasnesër, pra, jo nesër, që është e enjte, por do të shihemi prapë të premten në orën 9. 30. Faleminderit shumë.

Faleminderit, znj. Asistente e Sallës që e shoqëroni dëshmitarin.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

Do të rimblidhemi këtu ditën e premte, ditë kur -- ah, kjo i jep kohë Mbrojtjes që të përgatitet për kundrapyetjet. Besoj se kjo dhe shpresoj që kjo t'i japë kohën e mjaftueshme Mbrojtjes për t'u përgatitur.

Z. Avokat, a mund të na jepni një vlerësim paraprak sesa kohë mund t'ju duhet, sigurisht, vetëm çmuarje, e përafërt, do të jetë kjo. Nuk është se do t'ju kërkojmë llogari nëse nuk e respektoni atë kohë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit shumë. Kjo pauzë midis pyetjeve nga pala thirrëse dhe kundrapyetjeve është e mirëpritur.

Por mund të themi këtë që nuk është se janë hequr shumë materiale nga ajo që mendonim se do të përdoreshin me këtë dëshmitar, sepse shumica e të dhënave janë gjithashtu aty. Duke pasur parasysh edhe ritmin me të cilin po ecim, mendoj, se të paktën, të paktën, do të duhet më shumë se një ditë. Nëse ju ndihmoj me këtë vlerësim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat. Do t'i kthehemi kësaj teme të premten mbas dreke dhe pastaj do ta shohim se çdo bëjmë.

Në rregull atëherë. Ka ndonjë problem që do ta ngrejë ZPS-ja para Trupit Gjykues?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Jo tani. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Mbrojtës i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Vetëm një gjë, nëse mundem. Nuk pata mundësi që t'u përgjigjem kundërshtimit ndaj dokumentit që i tregova dëshmitarit *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

Tani, aty u bë kundërshtimi se emri i tretë nga këta të katër nuk del në dëshminë e dëshmitarit, por ka një shpjegim, domethënë, lidhur me këtë vetë në dokument. Thjesht këtë desha që ta them edhe pse nuk e thashë më përpara. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, unë desha t'ju pyes a e doni fjalën, po duket që doni të thoni diçka. Ju lutem.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Pyetja që bëra ishte, pse u tha që janë vetëm tre emra ndërkohë që janë katër emra, pra, ishte pyetja që nuk ishte e saktë. Ky ishte thelbi i asaj që ne u përpoqëm të themi.

Këtë deshëm të thoshim. Janë katër emra në dokument. Ndërkohë që pyetja ishte a pasaktë se thoshte se në këtë dokument janë tri emra. Ndërkohë që nuk përputhet me atë që nuk është në dokument, pyetja e saktë duhet të ishte bërë që janë katër emra në dokument dhe jo tre.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

Krahas kësaj ka ndonjë temë apo ndonjë gjë tjetër që doni

ta ngrini para Trupit Gjykues? Jo?

Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptova tani se ka edhe një gjë tjetër që cilën do doja që ta ngrija me palët dhe Mbrojtësin e Viktimave, që ka të bëjë me kalendarin e seancave.

Kemi rezervuar, kemi ndërmend të që bëjmë një këmbim të disa prej ditëve që i kemi rezervuar tashmë që të jemi këtu në sallë me palët dhe Mbrojtësin e Viktimave. Parimisht, kështu është ajo që do të donim të vepronim. Por, sigurisht, duam që të shikojmë se çfarë mendimi kanë palët dhe Mbrojtësi i Viktimave nëse e kanë vërtetë problem këtë këmbim të datave të seancave.

Për javën që fillon më datë 23 dhe vazhdon deri në datë 27 tetor, kemi ndërmend që të bëjmë seancë në 23, 24 dhe 25. Pra, në datë 26 dhe 27 të mos bëjmë seancë. Dhe në vend të kësaj, të bëjmë seancë në datë 5 dhe 6 tetor. Që të jemi gjithë javën e parë të tetorit domethënë.

Kështu që sugjerimi im duke qenë se nuk do kemi nesër seancë, do t'ju luteshim që të na përgjigjeshit me postë elektronike që nesër ose që sonte, sa më shpejt domethënë edhe pastaj të shohim se çfarë do të vendosim. Por parimisht këtë duam që të bëjmë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nëse mundem për atë periudhë ne

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F529RED dhe F631.*

nuk parashikojmë ndonjë pengesë për këtë kalendar. Nuk e di nëse do të ndryshojnë gjërat më mbrapa. Po, hë për hë, nuk kemi asnjë pengesë për datat e propozuara.

Z. LAWS: [Përkthim] Edhe ne thamë të njëjtën gjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë nga ana juaj shumë shpejt u përgjigjët pa pasë nevojë për postë elektronike.

Z. AOUINI: [Përkthim] Do t'ju kthejmë përgjigje sa më shpejt.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. Po mendoja, nesër do të ishte me shumë e dobishme.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Maksimumi nesër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull atëherë.

Nuk do të bëjmë seancë nesër. Do ta rifillojmë këtë seancë në orën 9.30 të premten.

Këtu ndërpritet seanca.

--- Seanca mbyllet në orën 16.35